

AKT- THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË

KUFIZUAR

“ Makina me Qera Tani ” Sh.p.k.

Në datë 25/03 / 2024 ortaket; te themeloje shoqërine tregëtare “**Makina me Qera Tani**” Sh.p.k. për të zhvilluar aktivitet tregëtar në fusha të ndryshme, si më poshtë:

Në bazë të legjislacionit shqiptar eshte vullnetin e lirë dhe të plotë, marrëveshjapër themelimin e shoqërisë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar “**Makina me Qera Tani**” Sh.p.k. e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”; ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar , si dhe tëlegjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijojnë:

Neni 1

Te themelojë një shoqëri tregëtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**Makina me Qera Tani**” Sh.p.k. “**Makina me Qera Tani**” Sh.p.k. është një subjekt juridik Shqiptar, të cilil i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërise tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet sipas ligjit.

Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Makina me Qera
- Shit-Blerje, makinash.
- Import eksport makinash.

Neni 4

- Shoqëria “**Makina me Qera Tani**” Sh.p.k. ka selinë e saj në adresën: “Qereke, Bashkia Kruje,nr Pasurie 233/2, zk 3096, Kodi Unik 3096001168”

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë “**Makina me Qera Tani**” Sh.p.k. do të jetë 5000€ dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortakët.

Neni 6

Kuota e pjesmarrjes eshte si më poshtë:

- 1-Elton Kovaci -1
- 2-Artan Zyberaj -1

Neni 7

Kohëzgjatja e shoqërisë “**Makina me Qera Tani**” Sh.p.k. do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund tëshpërbëhet në cdo kohë me vendim tëasamblesë së ortakëve.

Neni 8

I gjithë kapitali i vënë ortaku themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.

Neni 9

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga ortaku.Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 10

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria do të ndahen per ortakun sipas kuotes të pjesmarrjes në kapitalin themeltar si dhe nëpërmjet akteve të tjera notariale apo kontratave të punës që ata do të realizojnë, pasi të jetë lënë një shumë mënjanë të paktën sa një e njëzeta e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë.

Neni 11

Ne kohën e prishjes së shoqërisë ose të përfundimit të afatit, kur nuk ka zgjatje afati kapitali i shoqërisë pasi të hiqen debitë e saj do ti ndahet ortakut sipas kuotes të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.

Neni 12

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretët, është plotësisht i transferueshëm dhe për tu depozituar në një nga Bankat Shqiptare, ose për tu përdorur sipas nevojave të ortakëve të shoqërisë.

Neni 13

Ortaku ka këto të drejta dhe detyra themelore:

- të derdhi kuotën e kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në nenin 6,
- të marri pjesë në drejtimin e shoqërisë,
- të tërheqi fitimin e realizuar,
- të tërheqi aktivin resultant nga bilanci i likujdimit në rast të pushimit të aktivitetit të shoqërisë,
- të ruajë sekretin e aktivitetit të shoqërisë,
- të impenjohet për arritjen e objektivave të shoqërisë.

Neni 14

Organet e shoqërisë “**Makina me Qera Tani**” Sh.p.k. janë:

- Asambleja e Pergjithshme
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë
Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Elton Kovaci** për një afat 5 vjeçar.

Neni 15

Shoqëria tregëtare private “**Makina me Qera Tani** ” Sh.p.k. është person juridik shqipëtar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjisacionit shqiptar në fuqi dhe vecanërisht ligji 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregëtare” si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, të K. Civil si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 16

Marrëdhënet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit,që lidhet midis palëve në mbeshtetje të ligjit Nr.7961,date 12.07.1995 (KODIT TË PUNËS), si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

Neni 17

Mosmarrëveshjet e mundëshme që mund të lindin gjatë interpretimit apo zbatimit të kësaj kontrate palët do ti zgjidhin në rrugë miqësore, në të kundërt kompetencat për zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor përkatës.

Neni 18

Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statutit të shoqerisë dhe dispozitat e legjisacionit shqipëtar.

Neni 19

Ky Akt-themelimi është përpiluar në tre kopje origjinale.

Datë 25 / 03 / 2024

ORTAKET THEMELUES

Elton Kovaci



Arian Zyberaj

